

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “DIGITAL&INOVATION INVESTMENT” SHPK

Ortakët themelues të Shoqërisë :

Z. Lorenc GOGA, i biri i Thoma shtetas Italian, dtl.07.07.1985, lindur në Durrës dhe banues në Bergamo Rruga Santa Vincenza Gerosa i identifikuar me kartën e identitetit Nr.AV0458427;

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

mbledhur në Tiranë sot më datë 18/06/2018,

VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1. Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj “**DIGITAL&INOVATION INVESTMENT**” sh.p.k.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

NENI 2 Forma juridike

2.1 Shoqëria tregtare “**DIGITAL&INOVATION INVESTMENT**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3 Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen Sami Frasheri, pallati Delta Tirane



3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4 Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

NENI 5 Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:

- - **Kerkim, zhvillim dhe shitjen e prodhimit, shërbim informatik, editor, radio /televizion me te gjitha mjetet aktuale dhe ata ne te ardhemen, (satelit, DVTB, WEBTB, internet Broadcast) Edicion, libra dhe revista duke perfshire publicitet publikime leter dhe vidio. dministrim financiar e te mirave materiale Import eksport dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimoreë, bujqësorë, blektoralë, Formim Hoteleri - Turizem. Imobiliare blerje e shitje e cdo lloje per vete dhe per llogari te trete.**

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6 Kohëzgjatja e Shoqërisë.


6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- **Z. Lorenc GOGA**, zotëron një kuotë me vlerë 100000 (njqindmijë) lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.



7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjeshtëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8 **Organet e Shoqërisë**

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9 **Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Lorenc GOGA**

NENI 10 **Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 11 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES
Lorenc GOGA

